

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"SHEHU CO." shpk**

Ne Elbasan, sot me datë 19.11.2020, me cilesine e ortakut te vetem : Z.Ylli SHEHU i datelidjes 26.03.1958 madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, ka vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "SHEHU CO." shpk, (me poshte e quajtur "Shoqeria")

**KREU I**

**Neni 1**  
**Krijimi**

Shoqeria "SHEHU CO."shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "SHEHU CO." shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Z.Ylli SHEHU "ortaku i vetem , i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe nuk mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i tij përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ai gëzon 100% kuotën e shoqëris,si ortak i vetem.

**Neni 3**  
**Selia**

Shoqeria e ka seline kryesore, ne adresen: Rruga "Roza Buda",Lagjia "5 Maj",Elbasan. Zona Kadastrale 8525 Pasuria me numer 23/203,Kati i pare.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarise**



**Shitje - blerje, import – eksport, përpunim të bimëve mjekesore aromatike, kultivim të bimëve mjekesore aromatike, prodhim dhe eksport të esencave vajore.**

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKE.

**KREU II  
KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek.

Kapitali i mesiperm është nënshkruar tërësisht nga ortakët dhe vetëm i shoqërisë.

Z.Z.Ylli Shehu, zotëues i kuotes, që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100.000 lek.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut të vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emerimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakëve me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 8  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 9

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve/ Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve/ Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve/ Ortaku i vetem është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 10

##### Administrimi



Administrator i shoqerise eshte Z.Z.Ylli Shehu.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim i asamblese se ortakeve te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete.

## Neni 11

### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jene te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Ortaku i vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Ortaku i vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqërisë "SHEHU CO." shpk, u redaktua nga unë "ortaku i vetem themelues" në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË

"SHEHU CO." shpk

Z.YLLI SHEHU

